

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА  
KOMUNA E GRAÇANICËS  
MUNICIPALITY OF GRACANICA

Ср.М.К.К.

2090/24  
29 APR 2024

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.27/2008), nenit 9 paragrafi 7 të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës nr.08/L-260 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.26/2023), nenit 52 dhe nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 13 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e katërt të rregullt, e mbajtur më datën 29.04.2024, merr këtë:

## VENDIM Nr.22/2024/KG

## për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2023 dhe bartjen në vitin 2024

## Neni 1

Miratohet Vendimi për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2023 dhe bartjen në vitin 2024 në një shumë prej **402,535.73€**.

## Neni 2

Rritja e buxhetit nga të hyrat vetanake të komunës do të bëhet:

Në kategorinë e shpenzimeve **Mallra dhe shërbime** të rritet shuma për **202,535,73€** në Kodin e programit: **163** Administrata dhe personeli – Nën-programi: **16308** Administrata

Në kategorinë e shpenzimeve **Shpenzime komunale** të rritet shuma për **30.000,00€** në Kodin e programit: **163** Administrata dhe personeli – Nën-programi: **16308** Administrata

Në kategorinë e shpenzimeve **Subvencione dhe transfere** të rritet shuma për **170.000,00€** në Kodin e programit: **160** Zyra e kryetarit – Nën-programi: **16008** Zyra e kryetarit

## Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

## Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

